



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

SHPLLJE PËR VENDE VAKANTE

Në zbatim të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, Ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil” të ndryshuar, Kontrolli i Lartë i Shtetit hap procedurat për plotësimin e vendit vakant, “*Drejtor i Drejtorisë Juridike*”.

I. Përshkrimi i përgjithshëm i punës për pozicionin e mësipërm

Drejtori i Drejtorisë Juridike në KLSH:

1. Përgjigjet dhe jep llogari për veprimtarinë e drejtorisë dhe ecurinë e zbatimit të detyrave të ngarkuara përpara Kryetarit dhe Sekretarit të Përgjithshëm ose Drejtorit të Përgjithshëm, kur këta të fundit ngarkohen nga Kryetari.
2. Përpunon dhe harton kërkesat për kualifikim dhe trajnim për punonjësit e drejtorisë që drejton dhe në nivel institucioni.
3. Angazhohet dhe kontribuon me konsulencë juridike në çdo komision apo grup të posaçëm pune të caktuar nga Kryetari i KLSH-së dhe/ose Sekretari i Përgjithshëm.
4. Organizon dhe bën analiza, përgatit raporte dhe nxjerr përfundime për rritjen e efektivitetit të veprimtarisë së drejtorisë.
5. Bën propozime për ndryshime apo përmirësime në aktet ligjore apo nënligjore, kur gjykon se ato bien ndesh me legjislacionin në fuqi.
6. Jep mendime juridike, brenda kuadrit të dispozitave ligjore në fuqi.
7. Me autorizim të Kryetarit dhe/ose Sekretarit të Përgjithshëm, përfaqëson KLSH-në, në të gjitha proceset gjyqësore ku KLSH-ja është palë ndërgjyqëse.
8. Bashkëpunon me organet e prokurorisë dhe ndjek zbatimin e marrëveshjes së lidhur me këto institucione, në kuadër të luftës kundër korrupsionit.
9. Bën studime, analiza dhe përgjithësime të praktikës juridike në fushën e auditimit dhe/ose jurisprudencës, si dhe përgatit materiale për trajnimin e punonjësve të KLSH-së në fushën juridike.
10. Përgatit informacione e programe për zbatimin e detyrimeve e angazhimeve që rrjedhin në kuadër të integritimit evropian dhe në luftën kundër korrupsionit, të cilat i raporton para Kryetarit.
11. Me autorizim të Kryetarit mund të marrë pjesë në organizata dhe organizma të ndryshëm profesionalë, brenda dhe jashtë KLSH-së.
12. Me kërkesë të Departamentit përkatës merr pjesë personalisht apo autorizon një punonjës të drejtorisë për të marrë pjesë në takimet/ballafaqimet e organizuara nga departamentet e auditimit me subjektet e audituara pas dërgimit nga ana e tyre të komenteve mbi projekt raportet e KLSH-së. Drejtori i Drejtorisë në bashkëpunim sipas rastit punonjësit e drejtorisë përgatit kallëzimet penale që mund të rezultojnë nga vlerësimi ligjor i materialeve të dosjes së auditimit.

II. Kushtet që duhet të plotësojë kandidati dhe kriteret e veçanta

Kriteret e përgjithshme:

- të jenë shtetas shqiptar;
- të kenë zotësi të plotë për të vepruar;
- të zotërojnë gjuhën shqipe, të shkruar dhe të folur;

- të jenë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën përkatëse;
- të mos jenë të dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundërvajtjeje penale me dashje;
- ndaj tij/saj të mos jetë marrë masa disiplinore e largimit nga shërbimi civil, që nuk është shuar sipas ligjit.

Kriteret e veçanta:

- Të kenë kryer arsimin e lartë dhe të jenë diplomuar jo më poshtë se niveli Master Shkencor në Shkenca Juridike. Do të favorizohen kandidatët që kanë kryer studime pas universitare ose zotërojnë grada shkencore apo tituj akademik në fushën e jurisprudencës;
- Të kenë eksperiencë pune në fushën e jurisprudencës mbi 10 vjet;
- Të zotërojnë gjuhën angleze;
- Të kenë eksperiencë dhe kualifikime kombëtare ose ndërkombëtare në fushën e jurisprudencës;
- Të kenë aftësi të mira drejtuese, menaxhuese dhe komunikuese.
- Kandidatët që vijnë nga shërbimi civil duhet:
 - Të jenë nëpunës civil në kategorinë e mesme drejtuese;
 - Të mos kenë masë disiplinore në fuqi;
 - Të kenë të paktën vlerësimin e fundit “mirë” apo “shumë mirë”;

Kategoria e pagës për këtë vend pune është I-4.

III. Paraqitja e dokumenteve

Kandidatët që shprehin interesin për të aplikuar duhet të dorëzojnë këto dokumente:

- Kërkesë me shkrim;
- Jetëshkrim i përditësuar me të dhëna të plota dhe të sakta;
- Fotokopje të noterizuar të diplomës të nivelit Bachelor dhe Master Shkencor së bashku me listën e notave. Diplomat që janë marrë jashtë vendit, duhet të jenë njohur paraprakisht sipas legjislacionit në fuqi për njehsimin e diplomave;
- Fotokopje të librezës së punës;
- Fotokopje të letërnjoftimit;
- Vërtetim të gjendjes shëndetësore;
- Vërtetim të gjendjes gjyqësore;
- Vërtetim që nuk kanë masë disiplinore në fuqi;
- Fotokopje të dy vlerësimeve të fundit të rezultateve në punë;
- Vërtetim të kategorisë që mbajnë në shërbimin civil;
- Çdo dokument tjetër që vërteton plotësimin e kriterëve të mësipërme, si dhe trajnime, kualifikime, arsim shtesë, vlerësime pozitive të përmendura në jetëshkrim.

Dokumentacioni duhet të dorëzohet brenda datës 10.05.2024.

IV. Faza e verifikimit paraprak

Pas përfundimit të afatit për dorëzimin e dokumentacionit Drejtoria e Burimeve Njerëzore do të bëjë verifikimin paraprak të dosjeve të kandidatëve nëse plotësojnë kriteret dhe dokumentacionin e kërkuar. Në përfundim të këtij procesi, brenda afateve ligjore në faqen zyrtare të KLSH-së www.klsh.org.al më datë 15.05.2024 do të bëhet shpallja e listës së aplikuesve që plotësojnë kriteret e shpallura të vendit të punës, si dhe të dhëna mbi zhvillimin e testimit. Aplikantët që nuk do të kualifikohen do të njoftohen me email po në të njëjtën ditë.

Njoftimi për aplikantët e kualifikuar do të dërgohet për publikim edhe në portalin Shërbimi Kombëtar i Punësimit.

V. Konkurrimi

Kandidatët do të vlerësohen me shkrim mbi njohuritë në lidhje me:

- Ligjin nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”;
- Ligjin nr. 152/2013, “Për Nëpunësin Civil”, i ndryshuar dhe aktet nënligjore në zbatim të tij;
- Ligjin nr. 9131, datë 08.09.2003, “Për rregullat e etikës në administratën publike”;
- Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë;
- Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë;
- Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë;
- Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë;
- Rregulloren e Brendshme të Organizimit dhe Funksionimit të KLSH-së;
- Rregulloren e Procedurave të Auditimit në KLSH;
- Standardet ndërkombëtare INTOSAI.

Kandidatët gjatë intervistës së strukturuar me gojë do të vlerësohen lidhur me:

- Eksperiencën e tyre;
- Njohuritë, aftësitë dhe kompetencën lidhur me fushën profesionale, lidhur me drejtimin strategjik, si dhe aftësitë për të drejtuar dhe menaxhuar aktivitetin e drejtorisë;
- Njohjen e kuadrit ligjor si dhe standardeve ndërkombëtare apo praktikave të mira lidhur me Institucionet Supreme të Auditimit;
- Vizioni, motivimi dhe pritshmëritë e tyre për karrierën.

VI. Fazat dhe mënyra e vlerësimit të kandidatëve

Kandidatët do t’i nënshtrohen fazave të vlerësimit si, faza seleksionuese dhe faza konkurruese.

Faza seleksionuese ose verifikimi paraprak, ka për qëllim të verifikojë nëse kandidatët plotësojnë kriteret e përcaktuara në shpalljen për konkurrim.

Faza e konkurrimit, përfshin:

- a) vlerësimi i dokumentacionit (arsimimi, përvoja, trajnime të lidhura me fushën etj);
- b) testimi me shkrim;
- c) intervista e strukturuar me gojë.

VII. Njoftimi i kandidatëve

Në faqen zyrtare të KLSH-së www.klsh.org.al më datë **15.05.2024** do të bëhet shpallja e listës së verifikimit paraprak dhe datat e zhvillimit të konkurrimit për secilën fazë. Kandidatët do të njoftohen individualisht me email për rezultatet.

Njoftimet do të dërgohen për publikim edhe në portalin Shërbimi Kombëtar i Punësimit.

Konkurrimi është i hapur për nëpunës civil të kategorisë së mesme drejtuese të shërbimit civil dhe kandidatë të tjerë jashtë shërbimit civil që plotësojnë kriteret e vendit të punës.

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT